



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

NJË SHITESË NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR”, E MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 5, DATË 20.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 20 pika 1, shkronja “a”, të Kodit Zgjedhor, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Qëllimi i vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor” është të përcaktojë rregullat për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZAZ-së, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10019, datë 29.12.008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projektvendimi i propozuar për miratim përmban një shtesë në tekstin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, ku pas pikës 2, të nenit 7, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat të propozuar nga partia politike apo për shtetasit që kanë shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtarë apo sekretarë të KZAZ-së.”.

Ky ndryshim vjen si nevojë për të adresuar më mirë kompetencat që Kodi Zgjedhor u njeh Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe, në zbatim të nenit 14, pika 1, të Kodit Zgjedhor, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në lidhje me garantimin e së drejtës për të mbikëqyrur



procesin e rekrutimit të zyrtarëve zgjedhorë.

Në këtë rast, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka detyrimin t'u vendosë në dispozicion Komisionerit dhe Nënkomisionerit, krahas raportit për rezultatet e verifikimit të të dhënave të kandidaturave për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve të propozuar nga partitë politike dhe për shtetasit që kanë shprehur interes për t'u emëruar kryesisht, edhe dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat të propozuar.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin "Për një shtesë në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", e miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor".

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .1.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

NJË SHITESË NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR”, E MIRATUAR ME VENDIMIN NR.5, DATË 20.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR”

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Në tekstin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, e miratuar me vendimin nr.5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, pas pikës 2, të nenit 7, shtohet pika 2.1 , me këtë përmbajtje:

“2.1 Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat të propozuar nga partia politike apo për shtetasit që kanë shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtarë apo sekretarë të KZAZ-së.”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: .1.2023 Nr:
Ora:



Për një shtesë në vendimin nr.5, datë
20.11.2020, të Komisionit Rregullator

3. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar